



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH**

Numri i lëndës: 2024:112818

Datë: 13.01.2025

Numri i dokumentit: 06703921

**PPP.nr.1/23**

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil**, gjyqtarja Sabaheta Kurteshi me bashkëpunëtorin profesional Gjelbrim Gërdellaj, në çështjen juridike të përmbarrimit sipas propozimit për përmbarrim të **kreditorit M. E. nga fshati..., Komuna e Dragashit, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit av. S. B. nga Dragashi, kundër debitorit të përmbarrimit V. E. gjithashtu nga fshati..., Komuna e Dragashit, i përfaqësuar nga av. M. S. nga Dragashi, për përmbarrimin e Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prizren – Dega në Dragash C.nr.551/22 të dt. 21.10.2022 dhe i lejuar me Urdhërin për përmbarrim, P.nr.1463/22 të dt. 24.11.2022 të Përmbarruesit Privat M. S. R. nga Prizreni**, duke vendosur sipas prapsimit të ushtruar nga debitori i përmbarrimit V. E. respektivisht i autorizuari i tij av. M. S. nga Dragashi, kundër Urdhërit për përmbarrim P.nr.1463/22 i dt. 24.11.2022, të Përmbarruesit Privat M. S. R. nga Prizreni, jashtë seancës gjyqësore, me dt. 13.01.2025, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

Prapsimi i ushtruar nga debitori i përmbarrimit **V. E. nga fshati..., Komuna e Dragashit**, kundër Urdhërit të Përmbarrimit P.nr.1463/22 të dt. 24.11.2024, të Përmbarruesit Privat M. S. R. nga Prizreni, **Hudhët poshtë si i pas afatshëm.**

**A r s y e t i m**

Përmbarruesi privat M. S. R. nga Prizreni, si organ i përmbarrimit, me Urdhërin e tij për përmbarrim, P.nr.1463/22 të dt. 24.11.2022, ka lejuar propozimin për përmbarrim të kreditorit M. E. nga fshati..., Komuna e Dragashit, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit av. S. B. nga Dragashi, kundër debitorit të përmbarrimit V. E. gjithashtu nga fshati..., Komuna e Dragashit, i përfaqësuar nga av. M. S. nga Dragashi, për përmbarrimin e Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prizren – Dega në Dragash C.nr.551/22 të dt. 21.10.2022.

Kundër këtij Urdhëri për përmbarrim, pas pranimit të tij *me datën 25.11.2022 (e premte), jashtë afatit ligjor, me datën 07.12.2022 (e mërkurë), konfirmuar nga vula postare, te përmbarruesi privat M. S. R. nga Prizreni*, prapësim ka paraqitur debitori i përmbarrimit V. E. përmes të autorizuarit të tij av. M. S. nga Dragashi, dhe i cili në ndërkohë (Përmbarruesi Privat) me aktin e tij përcjellës P.nr.1463/22 të dt. 30.12.2022, kësaj gjykate me datë 06.01.2023, ia ka dërguar

shkresat e lëndës P.nr. 1463/22 për të vendosur për këtë prapësim e duke sqaruar se ky Urdhër i Përmbauesit Privat duhet të anulohet dhe të abrogohet për shkak se titulli përmbaues (Aktvendimi) nuk është i përshtatshëm për përmbaues, kjo pasi që titulli përmbaues nuk e përmban klauzolen e përmbauesit dhe si i tillë nuk mund të ekzekutohet kurse pala kreditore përmes të autorizuarit ka parashtruar pergjigje në prapësim me dt. 22.12.2022 me propozimin që prapësimi i palës debitorë të refuzohet dhe se kjo gjykatë pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, ka vlerësuar se prapësimi i ushtruar nga pala debitorë V. E. kundër Urdhërit të Përmbauesit, P.nr.1463/22 të dt. 24.11.2022, të Përmbauesit Privat M. S. R. nga Prizreni,

### **Është i pas afatshëm.**

Me shikim në shkresat e lëndës P.nr.1463/22, kjo gjykatë gjeti se në rastin konkret kemi të bëjmë me propozimin për përmbaues të një pale kreditore për përmbauesin e Aktvendimit C.nr.551/22 të dt. 21.10.2022 rreth masës së përkohshme e me propozim që organi përmbaues të ndërmarr të gjitha veprimet në lidhje me detyrimin e debitorit që ti ndërprej të gjitha punimet tokësore ndërtimore në pronën e kreditorit. Ndërsa përkitazi me prapësimin si mjet i rregullt juridik në procedurën e përmbauesit, bëhet fjalë në nenin 69 të LPP-së, derisa për shkaqet e parapara e për prapësim, bëhet fjalë në nenin 71 të LPP-së, e në rastin konkret kemi të bëjmë me një Aktvendim, si dokument përmbauesi dhe i cili ka të bëjë me masën e përkohshme, kurse pala kreditore propozimit për përmbaues ia ka bashkangjitur origjinalin e këtij titulli përmbaues mirëpo edhe përkundër këtyre arsyeve, prapësimin e saj pala debitorë e ka paraqitur pas kalimit të afatit 7 (shtatë) ditor për paraqitjen e tij, si mjet i rregullt juridik i goditjes së vendimeve të nxjerra në procedurën përmbauese e për këtë bëhet fjalë në nenin 73 të LPP-së, e në të cilin, thuhet se :''*Me vendim prapësimi mund të pranohet, refuzohet ose hidhet poshtë si i pa afatshëm, si jo komplet dhe i palejuar*'' . Meqenëse në rastin konkret, debitori i përmbauesit, V. E. prapësimin e tij të ushtruar kundër Urdhërit për përmbaues, P.nr.1463/22 të dt. 24.11.2022 të Përmbauesit Privat M. S. R. nga Prizreni e ka ushtruar pas kalimit të afatit 7 (shtatë) ditorë për paraqitjen e tij kjo gjykatë të njëjtin prapësim e hodhi poshtë si të pas kohshëm.

Prandaj nga ajo që u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi e në kuptim të nenit 3, 5, 21, 22 par.1 pika 2, 23 par 2, 24 par.2, 27, 36, 38, 43, 69, 71, 73 dhe nenit 77 të Ligjit të procedurës së përmbauesit (LPP) .

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM - DIVIZIONI CIVIL  
2024:112818, 13.01.2025**

**G j y q t a r j a,**

---

**Sabaheta Kurteshi**

### **KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë,  
Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afatin prej 7 ditësh  
nga dita e pranimit të aktvendimit, përmes kësaj gjykate.